

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.ANr. 253 Prot.Tiranë, më 03/11/2022

Lënda: Propozim për miratimin e Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve të Ditës në Avancë.

Drejtuar: **Entit Rregullator të Energjisë**
Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr. 1023, Tiranë.

I nderuar z. Ahmeti,

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana e ALPEX-it për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të ALPEX, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, paraqet para Jush propozimin për miratimin e Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve të Ditës në Avancë.

Ky propozim është dhënë duke marrë në konsideratë plotësimin e parashikimeve të Procedurës së Tregtimit të ALPEX sh.a, e cila është dërguar pranë jush me anë të shkresës Nr. 201 Prot. datë 29.08.2022 për miratim. Kjo Procedure parashikon në pikën B.1.5. që çdo urdhërporosi e vendosur nga Anëtari i Bursës duhet të përmbajë të paktën një Çmim Maksimal dhe Minimal të lejuar.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra, tashmë në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, duke patur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e këtij funksioni, vlerëson se zbatimi i Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve të Ditës në Avancë të miratuara nga Ju, do të ishte një vendim i domosdoshëm për funksionimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë sipas afatit të parashikuar nga ALPEX-i në bashkëpunim me Ofruesin e tij të Shërbimit në datën 23.11.2022.

ALPEX-i në hartimin e këtij propozimi i është referuar Rregullores Nr. 2019/943, datë 05.06.2019 “Mbi Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike” të Parlamentit Evropian, Metodologjinë e parashikuar në përputhje me Nenin 41(1) të Rregullores së Komisionit Evropian Nr. 2015/1222, datë 24.07.2015 “Të Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve” (CACM Regulation), në kuadër të nxitjes së konkurrencës efikase në prodhim, tregtim dhe furnizim me energji elektrike, garantimin e sigurisë operationale, garantimin e trajtimit të drejtë dhe jo diskriminues të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, të NEMO-ve, të Autoriteteve Rregullatore dhe Anëtarëve të Bursës, dhe duke marrë parasysh nevojën për një

treg të drejtë dhe pa probleme dhe formim të drejtë dhe të rregullt të çmimeve, si dhe referuar praktikave të ndjekura nga Bursat e Energjisë të vendeve Evropiane, për vendosjen e çmimeve të harmonizuara Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve të Ditës në Avancë përsa i përket Single Day Ahead Coupling (SDAC) – Bashkimi i Tregjeve të vetme të Ditës në Avancë, si dhe vendimit të fundit të konfirmuar nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) dhe Komisioni Evropian dhe pas publikimit të vendimit përkatës të Këshillit të Jashtëzakonshëm për Transport, Telekomunikacion dhe Energji (Extraordinary TTE), të mbledhjes të datës 9 shtator 2022, si dhe duke marrë në konsideratë procedurën e ndjekur nga Ofruesi i Shërbimit (Henex), propozojmë që çmimet të jenë në përputhje me sa më sipër, si vijon:

- a) Çmimi i lejuar Minimal për Ankandin e Tregut të Ditës në Avancë të jetë: **-500€/MWh**
- b) Çmimi i lejuar Maksimal për Ankandin e Tregut të Ditës në Avancë të jetë: **4,000€/MWh.**

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a

Sokol Dishnica

